



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.442/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partija Kosovskih Srba (PKS), dega në Leposaviq, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, dega në Leposaviq, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Partija Kosovskih Srba (PKS), dega në Leposaviq, e cila identifikohet me numër ZL.Anr.442/2017 e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Srpska Lista, dega në Leposaviq, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Partija Kosovskih Srba (PKS), dega në Leposaviq, me të cilën pretendon se subjekti politik Srpska Lista disa herë ka shkelur rregullat lidhur me zgjedhjet lokale komunale në Leposaviq me të cilën kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, Aleksandar Miletic, Stevan Petronijevic, Irena Petrovic, para qendrës së votimit 1201B në Leposaviq; Nenad Vukadinovic para QV-së 1205B në Lesak, gjatë ditës së votimit disa herë kanë qëndruar në hyrjet e QV-ve dhe në afërsi të tyre, në një distancë më të shkurtë se 25 metra, me qëllim të ndikimit ndaj votuesve. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se kandidati për kryetar të komunës, Zoran Todoc, në bashkëpunim me kryesuesen e vendvotimit 1201B/02R, Aleksandra Balovic, ka bërë ndikim ndaj votuesve para QV-së 1201B në Leposaviq me të cilën pretendon se shihet edhe nga fotografitë e bashkangjitura. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika a).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës së subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, Paneli i vlerësoj si

të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se nga video CD dhe fotografitë e ofruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohen se personat të cilët janë duke qëndruar në oborrin e QV-e dhe janë të subjektit politik Srpska Lista. Meqenëse nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se personat që pretendohet se kanë qëndruar afër QV-së janë të Listës Serbe, pasi që parashtuesi i ankesës nuk i ka prezantuar asnjë emër apo mbiemër për të identifikuar se cilit subjekt politik i përketin si dhe kohën e qëndrimit të tyre, dhe ndikimin eventual të tyre tek votuesit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.442/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Maziri**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.